



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:038795
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06230300

K.DH.SH.II.978/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhtija Ymer, kryetar kolegji, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.T.P “A...” me nr. të biznesit ... dhe me pronar A.D., me adresë në Skenderaj, rr. “....” të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” SH.A. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.R., jurist tek e paditura, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurit të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.2534/22 të datës 26.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.P “A...” me seli në Skenderaj, rr. “....”, dhe ankesa e paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” SH.A. nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr. 2534/22 të datës 26.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar KE.nr. 2534/22 të datës 26.03.2024, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si ne vijim:

“I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “A...” me pronar A.D. dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “P...”, që në emër të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e datës 07.02.2008, për shkallën prej 80% të përgjegjësisë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 15,751.41 EUR (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një euro e katër dhjetë e një euro cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në Kosovë mbi një (1) vit pa destinim të caktuar dhe atë nga data e paraqitjes së padisë 12.05.2008 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.T.P “A...” me pronar A.D. përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 3,937.85 EUR.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit dhe i padituri.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar lidhur me lartësinë e shumës së vlerësuar në emër të dëmit material të shkaktuar ndaj paditësit dhe shumën e përgjithshme të shpenzimeve procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e padituri për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i ankimuar ashtu që për pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje ose të bdryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket pikave të cekura lidhur me përgjegjësinë e paditësit dhe lartësinë e dëmshpërbilimit të gjykuar dhe shpenzimet e procedurale.

Paditësi dhe i padituri nuk kanë paraqit përgjigje ndaj ankesave të lartëcekuar me lartë.

Dhoma e Shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N.T.P “A... me seli në Skenderaj, rr. “.... me datën 12.05.2008 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S... nga Prishtina, për kompensimin e dëmit, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që për dëmin material të shkaktuar në makinën pronë e paditësit si pasojë e aksidentit të datës 07.02.2008 me fajin e të siguarit të të paditurës, t’ia kompensoj dëmin në vlerë prej 19,689.27 EUR me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës për periudhën mbi një (1) vit pa destinim të caktuar dhe atë nga dita e paraqitjes së paditëses e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar në rigjykim, pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor datës 15.03.2024, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata erdhi në përfundim se i padituri, duke pasur lëshime primare në shkaktimin e aksidentit, ka përgjegjësi në shkallë prej 80% për dëmin e shkaktuar në automjetin e paditësit në aksidentin e datës 02.07.2008, andaj në mbështetje të nenit 154 par.1 të LMD-së me të cilin përcaktohet se “*Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurin që t’ia kompensoj paditësit dëmin material të shkaktuar në vlerë prej 15,751.41 EUR nga totali i dëmit të konstatuar në këtë aksident në shumë prej 19,689.27 EUR. Si dhe si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit përtej shumës së gjykuar si në pikën I dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse në rastin konkret, nga gjendja faktike e vërtetuar u konstatua se paditësi ka pasur kontribut në shkaktimin e dëmit përmes lëshimeve sekondare të tij, të cilat gjykata i vlerësoi në shkallën prej 20%, andaj në mbështetje të nenit 192 par.1 të LMD-së me të cilin parashihet se “*I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjestimisht të pakësuar*” u vendos që në përpjesëtim me kontributin e paditësit në lartësinë e dëmit të shkaktuar, t’ia pakësoj shumën totale të kërkuar me kërkesëpadi në vlerë prej 3,937.85 EUR.

Dhoma e shkalles së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe mbi bazën e saj drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale respektivisht nenin 178 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), në të cilin është përcaktuar: *Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesit të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë. Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre. Në qoftë se nuk ka fajsi në asnjë anë zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta në qoftë se shkaqet e drejtërisë nuk kërkojnë gjë tjetër. Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht*, po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftushme sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë e cila bazohet në mendimin dhe konstatimin e supërekspertizës të dhënë nga ekspertët e komunikacionit si dhe në bazë të plotësimit të të njëjtës, me të cilën kanë konstatuar se përgjegjësia e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit është si vijon: se deri tek aksidenti i datës 07.02.2008 ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit “Golf TD”, këtu i siguaruari i të paditurës, pasi që i njëjti ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit në pjesën e rrugës ku një veprim i tillë ka qenë i ndaluar dhe ka drejtuar automjetin me shpejtësi rreth 70km/h e cila shpejtësi ka qenë më e madhe se shpejtësia e lejuar për atë pjesë të rrugës. Kështu ekspertët kanë konstatuar se drejtuesi i automjetit “Mercedes 211 D” këtu pronë e paditësit ka pasur lëshime sekondare, ashtu që i njëjti ka ndërmarrë veprimin e kthimit majtas pa u siguruar mirë se janë plotësuar të gjitha kushtet për kthim të sigurtë dhe në vendin ku një veprim i tillë ka qenë i ndaluar, andaj gjykata si rezultat i kësaj ka ardh deri te ndarja e përgjegjësis dhe atë 80% për të paditurën dhe 20% për paditësin me hollësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë, me ekspertizën e makinerisë së datës 26.05.2018 nga eksperti S.H. e ka vërtetuar lartësin e dëmit të shkaktuar me datën 02.07.2008, ku ka konstatuar se dëmtimet në automjet kanë qenë të mëdha ashtu që nuk ka arsyeshmëri ekonomike për riparimin e të njëjtit, me qenëse qarkullimi i mjetit në rast të riparimit nuk do bëhet në nivelin e duhur, andaj ka konstatuar se vlera e automjetit të ri sipas karkarakteristikave të paditësit duke zbritur vjetërsimin e tij si dhe duke zbritur pjesë të cilat nuk janë dëmtuar nga aksidenti, kap shumën prej 19,689.27euro. Mirëpo në rastin konkrete meqenëse në raportin e ekspertizës së komunikacionit është konstatuar se përgjegjësia në shkaktimin e aksidentit është e ndarë, kjo gjykatë vlerëson se shuma e cila i padituri ka për detyrim t'ia paguaj palës paditëse në emër të dëmit në automjet është në shumën prej 15.751.41€, andaj gjykata e shkallës së parë, rastin konkret i ka analizuar të gjitha provat në lidhshmërin me njëra tjetrën dhe të gjitha sëbashku dhe pastaj ka ardhë në përfundim të drejtë se paditësit duhet ti njihet e drejta e kompenzimit të dëmit material sipas përgjegjësisë së ndarë dhe këtë qëndrim e pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera e të paditurës dhe të paditësit, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të dy palëve në procedurë janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e palëve në procedurë lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore por të njëjtat i refuzoj si të pa bazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke marrë në propocion suksesin e arritur ashtu sipas nenit 452.2 të LPK-së, të cilën e mbështet edhe kjo gjykatë.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës ë Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.978/24 datë 23.09.2024

Kryetari i Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri